



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-119**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-200 PËR  
GREVAT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-200  
PËR GREVAT**

**Neni 1**

1. Neni 1 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim njohjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave për organizimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në grevë, sipas ligjeve të aplikueshme dhe standardeve ndërkombëtare

## Neni 2

Pas nenit 4 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 4.A, me tekstin si në vijim:

### Neni 4.A

Të punësuarit dhe punëdhënësit, ose organizatat e tyre përkatëse, kanë të drejtën e negociimit dhe lidhjes së marrëveshjeve kolektive në nivelet e duhura, për të mbrojtur interesat e tyre, duke përfshirë edhe të drejtën në grevë.

## Neni 3

Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 1, fshihet togfjalëshi “**gjysma e të punësuarve**“ dhe zëvendësohet me togfjalëshin “**një e treta (1/3) e të punësuarve**”.

## Neni 4

1. Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. fshihet fjala “**sindikatë**” dhe zëvendësohet me togfjalëshin “**organizatat sindikale**”.

2. Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. fshihet togfjalëshi “**gjysma e numrit të të punësuarve**” dhe zëvendësohet me togfjalëshin “**një e treta (1/3) e të punësuarve**”.

3. Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.4. organizatat sindikale nga njëra anë dhe punëdhënësi nga ana tjetër, kanë bërë përpjeke, që të arrijnë pajtim, përmes ndërmjetësuesit të licencuar, sipas rregullave dhe procedurave të Ligjit për Ndërmjetësim.

4. Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.5. shtohet nënparagraf i ri 1.6., me tekstin si në vijim:

1.6. kur të punësuarit vendosin për të deklaruar grevën me votim të fshehtë, së paku me një të tretën (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve sindikal të organizatave sindikale apo brenda një organizate të caktuar punuese, ku nuk ka organizim sindikal.

## Neni 5

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 2, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Grevat nuk mund të deklarohen para së të jenë shterur/përdorur më parë procedurat e pajtimit dhe ndërmjetësimit, sipas ligjit për ndërmjetësimin dhe me kusht që këto procedura të jenë të përshtatshme, të paanshme, të shpejta si dhe që palët të kenë mundësinë e pjesëmarrjes në çdo fazë.

2. Neni 9 i ligjit bazik, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri 2.a., me tekstin si në vijim:

2.a. Në rastet kur greva organizohet në shërbimet e rëndësisë jetike, ku duhet të sigurohet minimumi i procesit të punës, palët janë të detyruara, që para deklarimit të grevës, t'i kenë shterur/përdorur procedurat e pajtimit dhe ndërmjetësimit.

3. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3, fshihet togfjalëshi “**apo më shumë se gjysma e të punësuarve**” dhe zëvendësohen me togfjalëshin “**apo një e treta (1/3) e të punësuarve**”.

## Neni 6

1. Neni 13 i ligjit bazik, pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri 3, me tekstin si në vijim:

3. Të punësuarit të cilët punojnë gjatë grevës, në shërbimet e rëndësisë jetike me qëllim të sigurimit të minimumit të procesit të punës, kanë të drejtë në pagë, në përputhje me kohën e kaluar në punë.

## Neni 7

1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas togfjalëshit “**Kontrata e Punës**” shtohet fjalia “**duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punuar**”.

2. Neni 18 i ligjit bazik, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri 1.a. me tekstin si në vijim:

1.a. Periudha e pezullimit sipas paragrafit 1. nuk prek vjetërsin në punë dhe efektet e saj.

## Neni 8

1. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 1. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 2, fjala “**tri (3)**” zëvendësohet me fjalën “**pesë (5) ditë**”.

## Neni 9

Neni 22 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

### Neni 22 Procedura e pajtimit

1. Këshilli grevist, në pëputhje me nenin 5 paragrafin 1. të këtij ligji, para se të deklarohet për organizimin dhe mbajtjen e grevës, është i detyruar të përdorë të gjitha mjetet për zgjidhjen e çështjeve kontestuese me punëdhënësin.
2. Këshilli grevist edhe gjatë mbajtjes së grevës duhet të angazhohet që t’i zgjidhin me marrëveshje kërkesat e tyre, drejtuar punëdhënësit.
3. Me pëlqimin e palëve për zgjidhjen e çështjeve kontestuese me marrëveshje, mund të angazhohen, ndërmjetësues të licencuar nga regjistri i ndërmjetësve të Republikës së Kosovës.
4. Marrëveshja e arritur në mes të palëve në formë të shkruar, përmes ndërmjetësuesit, ka fuqi ligjore, pas nënshkrimit të palëve dhe ndërmjetësit.
5. Shpenzimet për angazhimin e ndërmjetësit të licencuar në zgjidhjen e kontestit në mes punëdhënësit dhe Këshillit Grevist i bartin të dy palët, duke pasur parasysh tarifat e caktuara për ndërmjetës.

## Neni 10

1. Neni 25 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. fshihet togfjalëshi “**sipas nenit 11**” dhe zëvendësohen me togfjalëshin “**sipas nenit 13**”.
2. Neni 25 i ligjit bazik, paragrafi 2., pas nënparagrafit 2.3. shtohet nën paragrafi i ri 2.4, me tekstin në vijim:

2.4. vepron në kundërshtim me nenin 6 të ligjit bazik dhe nenin 4 të këtij ligji.

**Neni 11**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikë së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-119**  
**6 shtator 2012**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**